



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 487/13 Prot.

Tiranë, më 11/3/2014

REKOMANDIM

Nr. 18, datë 11/03/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit" (AKSHI) Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrin nr. 238 datë 08.11.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit" (AKSHI) me objekt:

- Siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave në infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit në platformën e "Qeverisjes Elektronike" (e Government).
- Procesi i Njoftim Regjistrimit.

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. "Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, objekti dhe veprimtaria e të cilit lidhet me "Zbatimin e politikave dhe të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit".

Pranë kontrolluesit (AKSHI), është ngritur "Qendra e të Dhënave Qeveritare" e cila siguron standarde bashkëkohore, kushte për serverët dhe mundëson që të gjithë shërbimet online qeveritare të jenë të qendëruara dhe të integruara. Aktualisht në "Qendrën e të Dhënave Qeveritare" janë në funksionim mbi 12 shërbime të përqendruara qeveritare, të ofruara për rreth 176 institucione të administratës publike.

Kontrolluesi nëpërmjet "Qendrës së të Dhënave Qeveritare" siguron standarde bashkëkohore dhe kushte teknike për serverët e Institucioneve publike. AKSHI nuk ka akses në serverë apo të dhënat të cilat mblidhen, përpunohen apo publikohen nga këto Institucione. Qëllimi i dhënies së shërbimit nëpërmjet "Qendrës së të Dhënave Qeveritare" është që t'u sigurojë Institucioneve publike sigurinë, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve dhe të dhënave që përpunohen në to.

Kontrolluesi ka qenë pjesë e projektit "IPA EuropeAid/129607/C/SER. Suport për AKSHI më qëllim ndërtimin e një infrastrukture e-gov në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave personale të BE) dhe krijimi i infrastrukturës është zhvilluar në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontrolluesi në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, ka kryer njoftimin për përpunimin e të dhënave personale pranë zyrës së Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që ai ka marrë për të dhënat personale të tyre.

Në faqet zyrtare në internet [www.akshi.gov.al](http://www.akshi.gov.al) dhe [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al), nuk ka publikuar "politikat e privatësisë" (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në këtë rast kontrolluesi ka shkelur nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mbledhen nga subjektet e interesuar, informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqeve në internet duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

2. Kontrolluesi disponon një "Data Center" sekondar i cili shërben si "Backup" për "Qendrën e të Dhënave Qeveritare, Site Primar", i vendosur në të njëjtën godinë të kontrolluesit dhe është në proces për zhvendosjen e "Site Sekondar" në vendndodhjen e përcaktuar në vendimin nr. 219 dt. 20.02.2013 të Këshillit të Ministrave.

Në këtë rast kontrolluesi ka shkelur në nenin 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 21 datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj".

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se është shumë e rëndësishme ruajtja në një ambient tjetër të kontrolluesit i "Site Sekondar". Zhvendosja e tij në vendin e përcaktuar në vendimin nr. 219 dt. 20.02.2013 të Këshillit të Ministrave, është imediate sepse ka të bëjë me sigurinë fizike të të dhënave personale dhe informacioneve që mbledhen nga një numër i konsiderueshëm Institucionesh të rëndësishme publike. Përsheptimi dhe plotësimi i kësaj detyre është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të

subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryhen nga Institucionet publike.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

- Në faqet tuaja në internet [www.akshi.gov.al](http://www.akshi.gov.al) dhe [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al), të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t’i gjeni në Opinionin “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat” publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al).

2. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 21 datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”:

- Të merren masat për zhvendosjen e menjëhershme të “Site Sekondar” në vendndodhjen e përcaktuar në vendimin nr. 219 dt. 20.02.2013 të Këshillit të Ministrave.

3. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit.. “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

